



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.883/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari- anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.883/2021 të datës 22.10.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. "Ismail Dumoshi", Nr.5, Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 02.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.883/2021 e datës 22.10.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër 05/2021 i datës 20.09.2021 i Komisionit të Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë.
- III. Anullohet procedura e rekrutimit "Lëvizje brenda kategorisë" me Nr.ref.RP00007311 për pozitën Auditor i Brendshëm" i shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 21.07.2021, si dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me këtë procedurë të rekrutimit.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare Ligjore pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 22.10.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër 05/2021 të datës 20.09.2021 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen brenda Kategorisë në Shërbimin Civil, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale si dhe vlerësimit të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 27.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Këshilli, me datë 09.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.883/2021 me numër protokolli 5143/2021 të datës 22.10.2021, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 20.09.2021, me numër protokolli 1512-120 i Komisionit të Vlerësimit brenda kategorisë; Lista përfundimtare e renditjes të kandidatëve për pozitën "Auditor i Brendshëm"; E- maili i datës 08.09.2021, dërguar nga Burimet njerëzore për ankuesen

E- maili i datës 19.08.2021, dërguar nga Burimet njerëzore për ankuesen

Njoftimi për Listën e ngushtë; Njoftimi i datës 26.08.2021; Procesverbali i datës 05.08.2021, i Komisionit për Ekonomi, Industri Ndërmarrësi dhe Trageti; Procesverbali i datës 12.08.2021, i Komisionit për Ekonomi, Industri Ndërmarrësi dhe Trageti; Konkursi i datës 21.07.2021; Ankesë e datës 15.09.2021, drejtuar Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes brenda; Vendimi i datës 18.08.2021, për Themelimin e Komisionit për Vlerësimin për Lëvizje Brenda kategorisë; Renditja Përfundimtare e kandidatëve; Vendimi i datës 13.08.2021, për pezullimi parandalues; dëshmi e datës 17.05.2021, për mase disiplinore; Dëshmi e datës 17.05.2021, për përvojën e punës; Akt Emërimi i datës 07.11.2021, për ankuesen Vendimi i datës 21.04.2021, për zëvendësim; Vendimi i datës 10.07.2020, për zëvendësimin e letër reference e datës 28.05.2015; Vendim i datës 18.12.2014; Vendimi i datës 29.09.2014, për Themelimin e Komisionit për Ankesa; Vërtetimi i datës 10.05.2016 ; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020, për ankuesen Certifikatë e datës 25.09.2019; Diplomë e datës 28.04.2004; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019, për ankuesen Vërtetimi i datës 09.08.2021, për ankuesen dëshmi e datës 29.07.2021, për masën disiplinore, për Vendimi i datës 29.07.2016, për Emërimin e anëtareve të Komunitetit të Auditimit; Certifikatë e vitit 2004; Diplomë e datës 30.12.2002; për Certifikatë e datës 15-16 dhjetor e vitit 2016; Certifikatë e datës 20-21, prill e vitit 2015; Diplomë e datës 22.10.2014, për Diplomë e datës 17.09.2019 për Vërtetimin e datës 15-16 e vitit 2019; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë për Vërtetimin e datës 27.07.2021; Vërtetim i datës 27.07.2021 për Diplomë e datës 11.03.2004 për Vertetim për periudhën e punës i datë 10.08.2021, për dëshmi e datës 10.08.2021, për masën disiplinore për Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë për Vërtetimi i datës 25.10.2011; Diplomë e datës 26.12.2003, për Diplomë e datës 20.01.2012, për

Kontratë e punës e datës 23.11.2009, për Akt Emërimi i datës 01.02.2012 për Kontratë e punës e datës 23.11.2013, për Kontratë e punës e datës 23.11.2010 për vendimi i datës 28.010.2021, për vërtetim i datës 29.07.2021; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për dëshmi e datës 29.07.2021, për masën disiplinore për Vërtetim i datës 07.07.2021; diplomë e datës 19.01.2010, për diplomë e datës 07.07.1992, për vendim i datës 10.07.2020, për Akt Emërimi i datës 05.09.2012, për Ndryshimi dhe plotësimi i akt Emërimit i datës 20.01.2015; vërtetimi i datës 16.12.2019, për Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019, për vërtetimi i datës 09.08.2021, për certifikatë e datës 20.01.2021; certifikatë e muajit shtator dhjetor e vitit 2005; Diplomë e datës 13.01.2015, për licence e datës 15.02.2018, Certifikatë e datës 01.01.2015, për vendimi i datës 24.02.2012; vërtetim i datës 10.08.2021, për Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për Përgjigje në ankesë e datës 09.11.2021; Akt Emërimi i datës 30.04.2016, për Akt Emërimi i datës 02.07.2018, për Akt Emërimi i datës 01.12.2021, për Akt Emërimi i datës 03.12.2018, për Akt Emërimi i datës 16.11.2018, për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Sipas shkresave të lëndës është konstatuar se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me datë 21.07.2021 ka shpallur konkursin me nr.ref.RP00007311 për "Lëvizje brenda kategorisë" për pozitën e punës Auditor i Brendshëm". Organi i punësimit me rastin e shpalljes se konkursit, ka përcaktuar kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, si në vijim: *Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën 'mirë' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit; Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.*

Ndërsa sipas Konkursit në fjalë si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Diplomë/ta të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor); Diplomë të studimeve universitare Fakulteti Ekonomik ose Fakulteti Juridik; Kualifikime të posaçme formale: Certifikata për Auditor të Brendshëm; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Në këtë konkurs kanë aplikuar tetë (8) kandidatë, dhe vetëm gjashtë (6) prej tyre janë vlerësuar se plotësojnë kriteret e konkursit dhe të njëjtit janë pjesë e listës së ngushtë të datës 19.08.2021.

Komisioni për Vlerësimi i themeluar sipas Vendimit Nr.161/2021 të datës 18.08.2021, pas përfundimit të procedurës së intervistimit, me datë 07.09.2021 ka përgatitur listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, sipas të cilës kandidati Arben Dodaj është listuar si kandidati me më së shumë pikë, me gjithsejtë 84.6 pikë, ndërsa ankuesja është renditur si kandidata e pestë me gjithsejtë 69.4 pikë. Bazuar në listën përfundimtare të Komisionit Vlerësues, Divizioni për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 08.09.2021 ka publikuar

10/09/2021 10:40

Njoftimin për kandidatin e suksesshëm, përmes të cilit, kandidati për emërim në pozitën e punës " Auditor i Brendshëm".

është rekomanduar

E pakënaqur me listën përfundimtare të datës 08.09.2021, ankuesja me datë 15.09.2021 ka parashtruar ankesë pranë Komisionin të Vlerësimit, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër 05/2021 të datës 20.09.2021, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar, me arsyetimin se pretendimet ankimore nuk kanë të bëjnë me fazën e vlerësimit.

Kundër Vendimit me numër 05/2021 të datës 20.09.2021 të Komisionit të Vlerësimit, ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Vendimi me numër 05/2021 i datës 20.09.2021 është nxjerr përmes shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale si dhe vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke shtuar me tej se Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me të cilën janë përcaktuar kërkesat për lëvizje brenda kategorisë për faktin se ka lejuar pjesëmarrjen dhe përzgjedhjen e kandidatit i cili ka pozitën e funksionarit publik, respektivisht të anëtarit të KOSTT-it.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se plotësimi i pozitave të lira në Shërbimin Civil, në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, fillimisht bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, e cila procedurë e konkurrimit është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të Shërbimit Civil. Ndërsa Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka specifikuar kushtet dhe kërkesat e veçanta për lëvizjen brenda kategorisë përkatësisht me nenin 41 të kësaj rregullore përcaktohet se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurim për lëvizjen brenda kategorisë".

Kolegji, bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimin me numër protokolli 154 të datës 05.09.2012 ka gjetur se kandidati i përzgjedhur me datë 05.09.2012 është emëruar në pozitë e punës Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), ndërsa sipas Vendimit me Nr.07-V-023 të datës 10.07.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës i njëjti me datë 10.07.2020 është emëruar anëtar i Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSST). Kandidati përmes Vendimit Nr.147 të datës 13.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së ka pezulluar marrëdhënien e punës në Akademinë e Kosovës për Siguri. Sipas provave të lëndës, vendimi mbi pezullimin e marrëdhënies se punës është përcjell në Divizionin për Burime

Njerëzore, pas shpalljes së njoftimit për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshme, respektivisht me datë 14.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar si me lartë konstaton se kandidati me rastin e aplikimit në pozitën e Auditorit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ka aplikuar për lëvizje në kategori profesionale në kuadër të Shërbimit Civil, duke qenë nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, gjegjësisht Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa. Andaj mbi bazën e këtij konstatimi dhe në kuptim të dispozitave të nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji konstaton se kandidati i përzgjedhur nuk ka mundur të aplikojë për lëvizje në kategori në një pozitë të kategorisë tjetër, gjegjësisht kategorisë profesional në kuadër të Shërbimit Civil. Kolegji, po ashtu bazuar në shkresat e lëndës konstaton se kandidati i përzgjedhur me rastin e aplikimit në pozitën e Auditorit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ka qenë duke ushtruar funksionin e anëtarit të Bordit të KOSST-it, andaj në kuptim të nenit 55 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vlerëson se i njëjti në cilësinë e funksionarit publik nuk ka mundur t'i nënshtrohet procedurës së konkurrimit për lëvizje në kategori, në kuadër të Shërbimit Civil, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Andaj, Kolegji bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, konstaton se organi i punësimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 05/2021 të datës 20.09.2021 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses, nuk ka zbatuar drejtë ligjin material, kështu që në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.883/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.